

---

## Ftesë për ofertë Pa parakualifikim

**KOSOVË**

**PROJEKTI PËR SIGURINË E UJIT DHE MBROJTJEN E KANALIT**

**Nr. i Kredisë: 5902-XK**

**Titulli i Kontratës: Punët e mbetura për Rehabilitimin e Kanalit kryesor të Ibër Lepencit**

**Nr. i referencës: WSCP-W-ICB-1\_Punët e mbetura**

*Qeveria e Kosovës ka marrë financim nga Banka Botërore për koston e Projektit për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit, dhe synon të përdorë një pjesë të të ardhurave për pagesat për një kontratë për Punimet për Rehabilitimin e Kanalit të Ibër Lepencit.*

N.H. Ibër Lepenc (IL) tani bën ftesë për oferta të mbyllura nga ofertuesit e kualifikuar për **Rehabilitimin e Kanalit të Ibër Lepencit**, duke përfshirë ndër të tjera punimet kryesore si më poshtë:

- Punime të dheut dhe Pastrim
- Rehabilitimi i kanalit
- Anashkalimi i ujit
- Rezervuari i ujit (Bufer)
- Punimet e Betonit
- Rrugët e aksesit/qasjes

Qëllimi është që të riparohen dhe rehabilitohen pjesët e hapura të Kanalit për të reduktuar humbjet e ujit për shkak të dëmtimit gjatë 40 viteve të fundit dhe që të mbahet funksioni i Kanalit i qëndrueshëm. Kanali është afërsisht 49 km i gjatë dhe kalon nëpër 4 komunat Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri dhe Obiliq. Pjesët e hapura të Kanalit kanë një gjatësi prej afërsisht 21 km. Pjesët nëntokësore të Kanalit do të rehabilitohen në një fazë të mëvonshme, gjë që nuk është pjesë e kësaj kontrate.

**Ofertues-i(-ët) e interesuar duhet të kenë parasysh se kontrata për këtë fushë veprimtari është dhënë në vitin 2020, megjithatë për shkak të mos përmbushjes nga ana e kontraktorit, vetëm disa pjesë të fushë veprimtarisë janë përfunduar ndërsa pjesa më e madhe e punëve kanë mbetur të papërfunduara. Kontrata e sipërpërmendur është shkëputur dhe ky tender i ri është për punët e papërfunduara.**

**Periodha e kohëzgjatjes së punimeve për këtë tender është 22 muaj.**

Ofertuesit me kualifikimet minimale kryesore të mëposhtme konsiderohen të kualifikuar për dhënie të kontratës. Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi të dokumentuara që plotëson përvojën dhe kërkesat financiare të mëposhtme:

- Përvojë të mëparshme të kontratës me të paktën **1 kontratë të ngjashme** me vlerë minimale **7,700,000 Euro duke përfshirë TVSH-në**. Kontrata të ngjashme duhet të bazohen në veshjen e kanaleve/sistemet e bartjes së ujit me kapacitet të ngjashëm ose më të madh të bartjes (p.sh. ujitje, kanalizim, kullim stuhish, furnizim me ujë me shumicë ose punë të tjera hidraulike të ngjashme) (përfshirë kanalet/akuaduktet).
- Qarkullim mesatar vjetor të ndërtimit në vlerë minimale prej **7,900,000 Euro** ose ekuivalent, llogaritur si totali i pagesave të certifikuar të marra për kontratat në vazhdim dhe/ose të përfunduara brenda çdo 3 viteve të njëpasnjëshme brenda 5 viteve të fundit. Për këtë qëllim do të përdoren vitet **2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021**.
- Qasje në, ose ka në dispozicion, mjete likuide, linjave kreditore dhe mjete të tjera financiare (të pavarura nga çdo paradhënie kontraktuale) të vlerësuara si 1,500,000 Euro ose ekuivalente për kontratën në fjalë duke mos llogaritur këtu obligime tjera të ofertuesve (kjo do të përfshijë gjithashtu disponueshmëri të parave të gatshme në bankë, të paktën 750,000 Euro ose një konfirmim nga një bankë për të ofruar një linjë kredie të vlefshme nga banka për kontratën në fjalë).

- Përvojë minimale specifike ndërtimi në aktivitetet kryesore të mëposhtme të përfunduara me sukses<sup>1</sup>:
  - (a) Ndërtimi i rrugëve apo rrugëve të aksesit (rrugë betoni me një korsi ose me shumë korsi) të paktën 5 objekte
  - (b) Riparimi i strukturave hidraulike prej betoni (të gërryera me çarje dhe armature/përforcim të dëmtuar), sipërfaqe 5000 m<sup>2</sup>

Për punët e mëposhtme të specializuara, Punëdhënësi lejon nënkontraktorët e specializuar:

- Aplikimi i çimentos të i papërshkueshëm nga uji / aplikimi ekuivalent i rrëshirës plastike / aplikimet e veshjeve hidroizoluese **të gjitha për strukturat ujore (përfshirë kanalet/akuaduktet)** me të paktën **2 projekte**, secili me vlerë minimale **500,000 EURO** ose të paktën 1 kontratë me vlerë minimale prej **1,000,000 EURO**

Punime hidraulike të anashkalimit me tub (Hydraulic duct bypass works) për riparim të kanalit pa ndërprerje të rrjedhës së kanalit, të paktën **2 projekte** secili me vlerë minimale prej **1,000,000 Euro** ose të paktën **1 kontratë** prej së paku **1,500,000 Euro**

Ofertimi do të kryhet përmes procedurave të Tenderit Konkurses Ndërkombëtar siç specifikohet në *Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore: Prokurimi në financimin e projekteve investuese – Mallra, punë, shërbime jokonsulente dhe konsulente – korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe gusht 2018*, dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar siç përcaktohet në Rregulloren e Prokurimit. Për më tepër, ju lutemi referojuni paragrafëve 3.14 dhe 3.15 që parashtrajnë politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin më shumë informata nga:

***N.H. "Ibër Lepenc" Sh.A.***  
***Sheshi Bill Clinton, Nr. 13,***  
***Prishtinë, Kosovë***

Personi përgjegjës: Vigan Sylja (Koordinator i Projektit – WSCPP)

Telefoni: + 383 38 525 006

Email: [vigan.sylja@iber-lepenc.org](mailto:vigan.sylja@iber-lepenc.org)

Cc tek: [kushtrim.berisha@iber-lepenc.org](mailto:kushtrim.berisha@iber-lepenc.org) dhe [dmajumdar123@yahoo.com](mailto:dmajumdar123@yahoo.com)

Dhe mund të shikojnë dokumentet e tenderit gjatë orarit të punës nga ora **9 e mëngjesit deri në 4 pasdite në ditët e punës nga e hëna në të premte** në adresën e dhënë më lartë.:

Një komplet i dokumenteve të ofertimit në gjuhën **angleze** mund të blihet nga ofertuesit e interesuar të kualifikuar pas dorëzimit të një aplikacioni me shkrim në adresën e mëposhtme dhe pas pagesës së një tarife të pakthyeshme në vlerë prej **200 Euro**. Mënyra e pagesës do të jetë pagesa me para në dorë ose transfer bankar në:

Mbajtësi i llogarisë:

**NH IBËR LEPENC SHA - WB**

Banka:

**BANKA KOMBËTARE TREGTARE - KOSOVA**

Numri i llogarisë:

**1901 2179 3504 1302**

Swift kodi:

**NCBAXKPR**

IBAN:

**XK051901217935041302**

Dokumenti do t'i dorëzohet ofertuesit ose do të dërgohet me korrier në adresën e specifikuar nga Ofertuesi nëse kjo kërkohet në mënyrë specifike nga Ofertuesi. Për lehtësinë e Ofertuesve, një kopje elektronike e Dosjes së Tenderit mund t'u dërgohet ofertuesve të cilët e kërkojnë të njëjtën në adresën e emailit të shënuar nga Ofertuesi. Kopja elektronike e Dosjes së Tenderit do t'u lëshohet ofertuesve pas pranimit së detajeve të konfirmimit të pagesës së blerjes së Dosjes së Tenderit nga Ofertuesi.

Një takim para ofertës do të zhvillohet në datën, orën dhe vendin e mëposhtëm:

Data: **15 shkurt 2023**  
Ora: **10.00**  
Vendi: **NH “Ibër Lepenc” SHA**  
Adresa: **Sheshi Bill Clinton, Nr. 13**  
Kati: **Kati i dytë**  
Shteti: **Kosovë**

Një vizitë në terren do të organizohet nga Punëdhënësi më **16 shkurt 2023, detajet e lokacionit dhe pikës së takimit për vizitën në terren do të ndahen me të gjithë ofertuesit e interesuar gjatë takimit sjarues (para-ofertues).**

Duke pasur parasysh nevojën që ofertuesit të kuptojnë qartë qëllimin e plotë të punimeve dhe strategjinë për realizimin e tyre në përputhje me projektin konceptual të projektit dhe paramasës, pjesëmarrja e ofertuesve në vizitën në terren është e detyrueshme. Ofertuesve u kërkohet që ta konfirmojnë këtë në letrën e ofertës (sipas modelit të letrës së ofertës në seksionin IV, Formularët e Ofertës)

Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme më ose përpara datës **15 Mars 2023 (ora 10.00)**. Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. **Ofertat e vonuara do të refuzohen.** Ofertat do të hapen publikisht në prani të përfaqësuesve të autorizuar të ofertuesve dhe kujtdo që zgjedh të merr pjesë në adresën e mëposhtme më **15 mars 2023 (ora 10.00)**.

Të gjitha ofertave duhet të u bashkëngjitet një Policë e Sigurimit të Ofertës në vlerë prej 200,000.00 Euro

Adresa e përmendur më sipër është:

***NH “Ibër Lepenc” SHA***  
***Zyra qendrore***  
***Sheshi Bill Clinton, Nr. 13***  
***Prishtinë, Kosovë***

Personi përgjegjës: Vigan Sylja (Kordinator i Projektit – WSCPP)  
Telefoni: + 383 38 525 006